



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVA  
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT  
MUNICIPALITY OF DEÇAN  
OPSTINA DEÇAN



Drejtoria për Mbrojtje, Shpëtim dhe  
Shërbime Publike

Nr. 09 /2025



Dt. 20 /01/2025

## RAPORT VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2025

Sektori i Shërbimeve Publike

E përgatiti :  
Udhëheqës i Sektorit për Shërbime Publike

  
Xhevat Lufaj

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVA REPUBLIKA KOSOVA
	KOMUNA E DEÇANIT MUNICIPALITY OF DEÇAN OPSTINA DEÇAN
Nr. 09	Drejtori për Mbrojtje dhe Shërbime Publike
Drejtori për Mbrojtje dhe Shërbime Publike	1522
09	20.01.26



Miratoi :  
Drejtori për D.M.SH.SH.P.

  
Izet Zenuni

## HYRJE

Drejtoria për M.SH.SH.P në organizimin e saj udhëhiqet nga Drejtori dhe është e ndarë në dy sektorë: Sektori për Mbrojtje dhe Shpëtim dhe Sektori për Shërbime Publike.


Sektori për Shërbime Publike në kuadër të organizimit dhe të strukturës së tij mbi punën dhe aktivitetet, është i organizuar më organogram: Shef i Sektorit të Shërbimeve Publike, Zyrtar për Ndërtim, Zyrtar për Transportin Publik, Zyrtar i Lartë për Menaxhimin e mbeturinave, që, përveç detyrave të përcaktuara me përshkrimin e vendit të punës, të parapara në neni 13 të Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në territorin e Komunës së Deçanit, ushtron edhe detyra dhe përgjegjësi të tjera shtesë që dalin nga veprimtaria e drejtorisë, sipas nevojës dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Sipas planifikimeve vjetore nga drejtoria, në Sektorin e Shërbimeve Publike, detyra parësore kanë qenë realizimi i projekteve në infrastrukturën rrugore, ndërtimi dhe mirëmbajtja e tyre, mirëmbajtja dhe zgjerimi i ndriçimit publik, menaxhimi i mbeturinave, ndërtimi i trotuareve, shesheve, ndërtimi dhe mirëmbajtja e kanalizimit, mirëmbajtja e varrezave publike si dhe ndërtimi i lapidareve të dëshmorëve, kujdesi për hapësirat publike në tërë territorin e komunës së Deçanit, kanalizimin e qytetit dhe detyra të tjera dytësore që dalin gjatë vitit. Po ashtu pjesë e aktiviteteve janë edhe punët e përbashkëta që janë me ndërmarrjet komunale dhe regjionale siç është, Kompania N.P.L. "Higjiena", Kompania Regjionale e Ujësjetësimit "Hidrodrini", Ndërmarrja Regjionale për Ujitje të tokave "Drini i Bardhë" si dhe bashkëpunimi me KEDS.

Koordinim dhe bashkërendim të punëve dhe aktiviteteve, me theks të veçantë, Sektori i Shërbimeve Publike ka pasur me NPL "Higjiena", ku shumicën e punëve të menaxhimit të mbeturinave dhe mirëmbajtjes së hapësirave publike, mirëmbajtjen dhe rregullimin e varrezave dhe Lapidarëve të Dëshmoreve, i ka të kontraktuara me kontratën "Në Shtëpi". I tërë ky aktivitet monitorohet në baza ditore dhe sipas nevojës, nga menaxheri i kontratës dhe zyrtari i lartë për menaxhimin e mbeturinave.

Raporti i punës do të përfshijë në mënyrë të detajuar të gjitha të dhënat mbi punët dhe aktivitetet e kryera gjatë vitit raportues, të paraqitura në formë tabelore dhe narrative, në përputhje të plotë me planifikimin e miratuar në vitin paraparak dhe aktet normative në fuqi.

## 1. Infrastruktura rrugore dhe mirëmbajtja gjatë vitit 2025



### 1.1 Asfaltimi i rrugëve në territorin e Komunës së Deçanit Janar- Dhjetor 2025

Nr.	Vendi dhe emri i rrugës	Km
	Përfundimi i kontratës për asfaltimin e rrugëve dhe rrugicave - LOT III (Llukë e Ulët, Llukë e Epërme, Dashinoc, Lumbardh, Strelle e Epërm)	28.0 km
	Fillimi i punimeve për asfaltimin e rrugëve dhe rrugicave në qytet dhe fshatrat e komunës - LOT IV (Kodralli, Strelle e Ulët)	6.3 km
	Mirëmbajtja Verore dhe Dimërore (Prerja e vegetacionit në një pjesë të territorit të komunës, sanimi dhe riasfaltimi i gropave në rrugët e komunës së Deçanit, mbushja me zhavorr dhe asfaltimi i një pjese të parkingut tek qendra Rinore, asfaltimi i rrugëve në fshatin Beleg, asfaltimi i rrugëve të lagjes së re tek “Podi i Geshtenjave” në Deçan.	6.6 km
	Vazhdojnë punimet në segmentin Lëbushë-Strelle	
	Fillimi i punimeve në rrugën e Gushavcit	
	Vazhdimi i ndërtimit të trotuareve në Komunën e Deçanit	
	<b>Total:</b>	<b>40.9 km</b>

## 1.2 Projektet

Projektet	Projekt i përfunduar/ në vazhdim
Vazhdojnë punimet në Shtëpinë Alpine "Shkëlzen Haradinaj"	në vazhdim
Fillimi i punimeve të kanaleve të ujitjes në fshatrat e Komunës së Deçanit	në vazhdim
Mirëmbajtjes Verore dhe dimërore	në vazhdim
Elektrifikimi i Bjeshkës së Belegut	në vazhdim
Ndërtimi i murit mbrojtës të "Ura e Demës"	Përfunduar
Vazhdimi i punimeve ndërtimore në fshatin Turistik, faza e I dhe II-të	në vazhdim
Ndërtimi i kanalizimit në rrugën "Elena Gjika " dhe rrugëve tjera	Një pjesë e projektit ka përfunduar, vazhdon projekti edhe në fshatra tjerë.
Ndërtimi i rrethojave dhe rregullimi i hapësirave brenda në oborret e Qendrës Rinore "Fetnete Ramosaj", N.P.L-së "Higjiena", "Kolonisë së Artisteve" dhe "Shtëpisë Alpine"	në vazhdim
Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës në Pleqë	në vazhdim
Ndërtimi i rrugës Bjeshka e Madhe ( Laku i Kryqës) — faza e II	në vazhdim
Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit dhe impiantit për fshatin Dranoc	në vazhdim
Vendosja dhe mirëmbajtja e tabelave informuese ,emërtimet e fshatrave, rrugëve etj	në vazhdim

## **2. Mirëmbajtja verore dhe dimërore**

Rrugët në territorin e Komunës së Deçanit mirëmbahen rregullisht si gjatë sezonit veror ashtu edhe dimëror.

## **3.Ujësjetësi**

Vazhdon bashkëpunimi i ngushtë me Kompaninë Regjionale të Ujësjetësit "K.R.U"Hydrodrini".

## **4.Mirëmbajtja dhe zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik**

Edhe gjatë vitit 2025, ka vazhduar mirëmbajtja dhe zgjerimi i ndriçimit publik eficient në tërë territorin e Komunës së Deçanit.

## **5. Mirëmbajtja e kanalizimit**

Komuna e Deçanit në bazë të marrëveshjes respektivisht kontratës me K.R.U “Hidrodrini” si dhe N.P.L. “Higjiena” ka bërë mirëmbajtjen e kanalizimit të ujërave të zeza, gropave septike dhe nyjave sanitare në territorin e Komunës së Deçanit, zhbllokimin e pusetave dhe pastrimi i tyre, zbrazja e gropave septike, gërmimi, furnizimi, ndërrimi i gypave deri në funksionalizimin e plotë të ujërave të zeza. Zhbllokimi dhe pastrimi i pusetave të kanalizimit të ujërave atmosferike. Vendosja e kapakëve metalik dhe të betonit të pusetave të kanalizimit të ujërave të zeza dhe ujërave atmosferike etj.

## **6. Vendosja dhe mirëmbajtja e tabelave informuese, emërtimet e fshatrave, rrugëve etj**

Gjatë pjesës së dytë të vitit 2025 ka filluar vendosja e tabelave të emërtimeve të vendbanimeve, tabelave informuese si dhe mirëmbajtja e tabelave të emërtimeve të rrugëve.

## **7. Aktivitetet e Komunës bashkë me N.P.L “Higjiena” -Kontrata “Në shtëpi”**



Ndër aktivitetet kryesore, Komuna e Deçanit konkretisht Sektori për Shërbime Publike, ka pasur me Ndërmarrjen Publike Lokale “ Higjiena” me mbikëqyrjen dhe monitorimin realizimit të punëve të kontraktuara sipas kontratës “Në Shtëpi”.

Me poshtë do t’i paraqesim punët dhe aktivitetet e kryera në shumë fusha së bashku me N.P.L.” Higjiena” si:

### **7.1 Mirëmbajtja e hapësirave publike**

Komuna e Deçanit në bazë të kontratës me kompanitë e kontraktuara, ka bërë mirëmbajtjen e hapësirave publike dhe të gjelbra duke përfshirë mbjelljen, ujitjen, mirëmbajtjen e mobilierisë urbane, riparimi i shtigjeve me kubëza, pastrimi dhe fshirja e rrugëve kryesore dhe trotuareve në qytet, kositja e parqeve, prerja e vegetacionit, sanimi i gropave dhe riasfaltimi i tyre, si dhe punë me ekskavator sipas kërkesës së Drejtorisë për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike.

### **7.2 Dekorimi i qytetit për festat zyrtare dhe festa tjera**

Dekorimi i qytetit për të gjitha festat zyrtare, vendosja e flamujve, ndërrimi i flamujve, vendosja e shtyllave të flamujve, dekorimi i qytetit për festat e fund vitit dhe dekorime tjera sipas kërkesës dhe nevojave nga D.M.SH.SH.P.

### **7.3 Mirëmbajtja e lapidarëve, memorialëve dhe varrezave të Dëshmorëve dhe varrezave publike**

Plani për mirëmbajtjen e lapidarëve, memorialëve dhe varrezave të dëshmorëve, pastrimi, mirëmbajtja e tyre, mbjellja e barit në parqet e tyre, renovimi i pllakave të dëmtuara, mirëmbajtja e hapësirave gjelbëruese përreth kompleksit të dëshmorëve, duke përfshirë prerjen dhe kositjen e barit, largimi i mbetjeve mes pllakave apo gurëve si dhe rregullimi i pemëve dekorative ka vazhduar në të gjitha fshatrat dhe varrezat në tërë territorin e komunës. Ndërrimin dhe vendosjen : të ulëseve të reja, shportave të mbeturinave si dhe mirëmbajtjen e rrethojave etj.

Mirëmbajtja e varrezave publike në gjithë territorin e komunës së Deçanit.

### **7.4 Eliminimi i deponive ilegale**

Gjatë vitit 2025 është bërë identifikimi i deponive ilegale të mbeturinave dhe janë marr masat për eliminimin e tyre. Gjithashtu është përgatitur dhe dorëzuar raporti vjetor për Agjencionin e Mbrojtjes së Mjedisit AMMK me të gjitha të dhënat e kërkuara.

### **8. Punë dhe aktivitete tjera sipas D.SH.P.-së**

- Gjatë 2025 është bërë vazhdimi i kontratave me lokalet afariste si dhe janë nënshkruar kontrata të reja me disa lokale për shfrytëzimin e hapësirave publike si dhe në baza të rregullta janë lëshuar faturat. Aktivitetet dhe punët tjera shtesë të pa planifikuara si: ndërhyrjet në pikat e rrezikut nga vërshimet, pastrimi gjatë vitit i PGM-ve (pikave të grumbullimit të mbeturinave), kanaleve të ujitjes, prerja e vegetacionit etj.
- Përgatitja e planeve të punës, raportin vjetor dhe dokumente tjera bazike për vitin 2025
  - Planifikimi i projekteve dhe i buxhetit për vitin 2025 për Sektorin Shërbime Publike
  - Raport i punëve dhe detyrave të planifikuara dhe të realizuara për vitin 2025
  - Përgatitje e planit vjetor të punës për vitin 2026.

## **9. Pjesëmarrje në punëtori, trajnime**

Pjesëmarrje në punëtori, trajnime: (Zyrtari i Lartë për MM):

- 20.02.2025 - Projekti i fizibilitetit për oborret e riciklimit në pesë komunat e rajonit të Dukagjinit-punëtorit e II-të, lokacionet e oborreve, skenarët e menaxhimit të mbeturinave, analizat financiare dhe të rentabilitetit, modelit të operimit të qendrës
- 03.03-07.03.2025 - Akademia e Kosovës për Siguri Publike AKSP-Vushtrri Trajnimi: Bazat e Menaxhimit Emergjent
- 06.03.2025 - Takimi i dytë online mbi iniciativën WiFi4WB (Wi-Fi për Ballkanin Perëndimor), projekt që është pjesë e iniciativës EU4Digital, bashkë financuar nga Bashkimi Europian dhe qeveria gjermane, dhe zbatohet nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ),
- 20.03.2025 - Takimi i përbashkët mes Asociacionit të Komunave të Kosovës, në bashkëpunim me Agjencionin për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës dhe GIZ-Kosova, projektit Kosovo for Green, procesi i raportimit vjetor, për indikatorët e performancës në fushën e menaxhimit të mbeturinave, sipas kërkesës për përmbushjen e obligimit ligjor vjetor -
- 07.04.2025 - Punëtorit e 4-të me Kolegjiumin për Ekonomi Qarkore për hartimin e Planit Ndër-Komunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave (PNMIM) në pesë komuna të rajonit të Dukagjinit: Pejë, Klinë, Istog, Deçan dhe Junik.
- 28.03.2025 - Dorëzimi/aplikimi për iniciativën WiFi4WB
- 14-16.04.2025 Berat – Shqipëri - Punëtori dhe Vizitë Studimore me Kolegjiumin për Ekonomi Qarkore Asociacioni i Komunave të Kosovës në hartimin e Planeve Nder komunale për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave, në bashkëpunim me GIZ,
- 16.05.2025 - Punëtorit e 5-të për hartimin e Planit Ndër-Komunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave(PNMIM) në pesë komuna e rajonit të Dukagjinit: Pejë, Klinë, Istog, Deçan dhe Junik.
- 22.05.2025 - Punëtorit e 6-të, për prezantimin e draftit final të Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM) për Planin Ndër-Komunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave (PNMIM) në pesë komunat e rajonit të Dukagjinit: Pejë, Klinë, Istog, Deçan dhe Junik.
- 25.06.2025 - Punëtorit e 3-të në kuadër të projektit të fizibilitetit për ndërtimin e Qendrave për Grumbullim dhe Riciklim të Mbeturinave (Oborreve të Riciklimit) për komunal e rajonit të Dukagjinit.
- 29.07.2025- Punëtorit e 6-të e Planit Ndër-Komunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave (PNMIM) për pesë komunat e rajonit të Dukagjinit: Pejë, Klinë, Istog, Deçan dhe Junik, lidhur me draft Marrëveshjen e Bashkëpunimit Ndër-komunal (MBNK) në fushën e menaxhimit të integruar të mbeturinave
- 08 deri më 12.09.2025 - në emër të Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK), mbështetur nga GIZ Kosova, projekti Kosovo for Green (K4G), në vazhden e zhvillimit të proceseve të ndërlidhura me Bashkëpunimin Ndërkomunal dhe Planifikimin Strategjik për Menaxhimin e Integruar të mbeturinave, Vizitë Studimore në Slloveni, e shoqëruar nga Pjesëmarrje në Konferencën për Ekonomi Qarkore, [PROGRAMME - Circular Economy Hotspot Slovenia 2025](#).

Qëllimi i kësaj vizite studimore është ofrimi i mundësisë për tri regjionet në Republikën e Kosovës, Gjilan & Ferizaj, Dukagjini dhe Mitrovica, të cilat janë në procesin e planifikimit të përbashkët për menaxhimin e integruar të mbeturinave, për shkëmbimin e praktikave të suksesshme Sllovene për menaxhimin e integruar të mbeturinave dhe ekonomin qarkore, zhvillimi i suksesshëm i procesit të Bashkëpunimit Ndërkomunal si dhe proceseve tjera të ndërlidhura me qasjen e menaxhimit të integruar.

Vizita studimore e shoqëruar me pjesëmarrjen në Konferencën Ndërkombëtare për Ekonomi Qarkore, Lubjanë. Konferenca do të shërbejë për të marrë përvoja nga shtetet e Bashkimit European mbi zgjidhjet ligjore, teknike dhe operacionale si dhe formës së implementimit të Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave dhe finalizimit të Marrëveshjes për Bashkëpunim Ndërkomunal.

- 31.10.2025 “Nga Politika në Praktikë: Ligji për Mbeturinat dhe Përgjegjësia e Zgjeruar e Prodhuesit (PZP)”- organizuar nga Asociacioni i Komunave të Kosovës, në bashkëpunim të ngushtë dhe mbështetur nga GIZ – Kosova (projekti „Kosovo for Green“) punëtori që synon të shërbejë si platformë konsultimi në mes të nivelit qendror dhe lokal, me fokus në temën e menaxhimit të integruar të mbeturinave dhe përfshin Grupin Punues për Ekonomi Qarkore (ZKMM-të) dhe grupin punues ndërministror për hartimin e Ligjit për Mbeturina.- Parku i Inovacionit dhe Trajnimit (ITP), Prizren
- Forcimi i Kapaciteteve Komunale për Zbatimin e Planeve të Integruara Ndërkomunale për Menaxhimin e Mbeturinave , që në emër të Asociacionit të Komunave të Kosovës, në bashkëpunim të ngushtë dhe mbështetur nga projekti i GIZ- Kosovo for Green, 18-20 nëntor 2025 Pejë

Të dhëna të përgjithshme për Komunën e Deçanit	
Hapësira e përgjithshme	293.94 km <sup>2</sup>
Popullsia	27.775
Gjithsej rrugë në territorin e komunës	416.975 km
Lokale	354.61 km
Regjionale	62.36 km
Rrugë të asfaltuara për vitin raportues (2025)	40.9 km (40.900 m)
Rrugë të pajisura me shenjëzim vertikal dhe horizontal	309 km
Trotuare	79.5 km
Shtigje të biçikletave	65 km
Ndriçimi publik i rrugëve	190 km
Hapësirat publike të përgjithshme	50
Hapësira publike me ndriçim	49
Hapësira publike	337174.2 m <sup>2</sup> (337.1472 ha)
Hapësira të gjelbra	289097.2 m <sup>2</sup> (289.10 ha)

#### • **Transporti Rrugor – Publik**

Gjatë vitit 2025 është bërë përcjellja e rregullt e linjave të transportit publik urban dhe rural në qytetin e Deçanit dhe fshatrat e tij.

Është bërë vazhdimi i lejeve dhe licencave për taksitë dhe kombi-busët, që operojnë në Komunën e Deçanit. Mbikëqyrja dhe vendosja e shenjave të komunikacionit si ato horizontale ashtu edhe vertikale sipas planifikimeve dhe nevojave si në qytet ashtu edhe në fshatra.

Bashkëveprim dhe koordinim me Policinë në raste të veçanta dhe kërkesa të ndërsjella. Si dhe punë dhe detyra tjera sipas planifikimit nga plani vjetor.

Në Komunën e Deçanit, vendbanime të përfshira në transportin lokal publik janë **37** nga **38**, përjashtim bënë fshati Belle për shkak të pozitës gjeografike ndërsa numri i vendndalimeve të pajisura me shenjëzim për automjetet e transportit lokal publik është **70**.

Nr.	Përshkrimi i detyrave	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qersh.	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nënt.	Dhjetor
1.	Bashkëpunimi me subjektet me rendësi të veçantë Policinë e Kosovës, Inspektoratin etj.	1	-	2	-	-	1	10	5	6	5	3	3
2.	Mbikëqyrja dhe kontrolli i masave të parapara ligjore kundër transporteve ilegale dhe të atyre që nuk e respektojnë orarin e përcaktuar nga organi kompetent.	2	-	3	2	3	5	3	3	5	3	2	5
3.	Caktimi i linjave për bartjen e udhëtareve në trafikun urban, vazhdimi i lejeve për transportin e udhëtareve.	1	-	-	-	-	-	3	3	2	2	2	2
4.	Dhënia e pëlqimit për regjistrimit e taksistëve sipas rregullores së komunikacionit	6											
5.	Kontrollimin e transportit të udhëtareve dhe mallrave	5											
6.	Kontrolli i vendqëndrimeve të caktuara për taxi nga shfrytëzuesit e tyre	10 gjatë vitit											
7.	Mbikëqyr rendin dhe orarin e udhëtimit nga operatorët për transportin e udhëtarëve	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1
8.	Përkujdesja për shënjimin vertikal dhe horizontal të rrugëve lokale.	Gjatë vitit											
9.	Lëshimi i lejeve për vendosjen e pengesave në rrugë dhe prerja e asfaltit për shtrirjen e kanalizimit, ujësjellësit.	-	-	2	4	1	3	-	-	-	-	-	-
10.	Lëshimi i vërtetimeve për student dhe punëtorët administrativ;	5	4	1	3	3	4	-	-	-	-	-	-